

KONTRATË DHURIMI KUOTASH

Në Tiranë, më datë 05.11.2025 palët si mëposhtë treguar, me vullnetin e tyre të lirë, bazuar në nenet 74 dhe 75 të ligjit 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, vendosën të nënshkruajnë këtë kontratë dhurimi mes tyre .

I. DHURUESI

Z. Eno SEFERI, i datëlindjes 14.04.1984, lindur në Tiranë, me shtetësi shqiptare, banues në Tiranë, me identifikuar me nr.personal I40414072V, në cilësinë e ortakut të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “ILLYRIA SHIPYARDS” sh.p.k., me seli në Njësia Administrative Farkë, Rruga “Ullishta”, Pallati Primavera, Kati 1, Zona Kadastrale 3266, Nr. Pasurie 96/64-N2, Tiranë, me NUIS (NIPT) M51506025D, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më datë 06.03.2025,(këtu e në vijim quajtur “Dhuruesi”).

II. PRANUES I DHURIMIT

Shoqëria tregtare “**SOLARIS CAPITAL TRUST**” sh.p.k, me seli në Njësia Administrative Farkë, Rruga “Ullishta”, Pallati Primavera, Kati 0, Zona Kadastrale 3266, Nr. Pasurie 96/64-N2, Tiranë me NUIS (NIPT) M52202071C, e përfaqësuar nga Znj. Anisa SEFERI, në cilësinë e administratorit të saj të ligjshëm, (këtu e në vijim quajtur “Përfituesi”).

Neni 1

Objekti i kontrates

Me këtë kontratë, Dhuruesi, si ortak në shoqërinë “ILLYRIA SHIPYARDS” sh.p.k., i cili zotëron 1 (një) kuotë që përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të saj, me vlerë nominale totale prej 100,000 (njëqindmijë) lekë, deklaron se dhuron pa asnjë kundërshtpërblim në favor të Përfituesit, 1 (një) kuotë të kapitalit të Shoqërisë “ILLYRIA SHIPYARDS” sh.p.k që përfaqëson 100% të kapitalit të kësaj shoqërie.

Neni 2

Pranimi i dhurimit

Përfituesi, nëpërmjet përfaqësuesit të tij të ligjshëm, deklaron se pranon dhurimin e sipërpërmendur dhe se është plotësisht në dijeni për vlerën, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i këtyre kuotave.

Neni 3

Gjendja juridike e kuotave

Dhuruesi deklaron se:



1. Kuotat objekt i kësaj kontrate janë pronë e tij e ligjshme dhe nuk janë të ngarkuara me barrë apo kufizime.
2. Kuotat nuk janë objekt i ndonjë padie gjyqësore apo pengu apo pretendimi nga të tretë.
3. Ai është i vetmi zotërues i tyre dhe ka të drejtë të disponojë lirisht mbi to, sipas nenit 73 të Ligjit nr. 9901/2008.

Neni 4 **Efektet juridike**

Efektet juridike të dhurimit fillojnë nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate, por prodhon efekt ndaj të tretëve dhe ndaj shoqërisë vetëm nga momenti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), sipas nenit 74 pika 2 të Ligjit nr. 9901/2008.

Pas regjistrimit, Përfituesi bëhet ortak i shoqërisë me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga zotërimi i kuotave.

Neni 5 **Përgjegjësitë dhe detyrimet tatimore**

Dhuruesi dhe Përfituesi janë në dijeni se dhurimi i kuotave mund të prodhojë detyrime tatimore në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi, të cilat do të përmbushen nga palët sipas ligjit. Palët zotohen të kryejnë të gjitha veprimet për regjistrimin e kalimit të kuotave në QKB brenda afatit ligjor.

Neni 6 **Deklarata e vullnetit**

Palët deklarojnë se kjo kontratë:

- Është lidhur me vullnet të lirë, pa mashtrim, dhunë apo kërcënim;
- Përfaqëson marrëveshjen e plotë dhe të vërtetë midis tyre;
- Është kuptuar plotësisht në përmbajtje dhe në pasojat juridike.

Neni 7 **Shpenzimet dhe kostot e regjistrimit**

Të gjitha shpenzimet pranë institucioneve shtetërore dhe çdo detyrim fiskal që mund të lindë dhe që mund të lidhet me këtë kontratë do të përballohen nga Përfituesi sipas marrëveshjes paraprake mes palëve.



Neni 8
Dispozita përfundimtare

Kjo kontratë hartohet në tre (3) kopje origjinale, nga të cilat një për Dhuruesin, një për Përfituesin dhe një për Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Çdo ndryshim ose shtesë në këtë kontratë do të jetë i vlefshëm vetëm nëse bëhet me akt të ri.

LEXUAR, MIRATUAR DHE NËNSHKRUAR NGA PALËT:

DHURUESI

Emo Seferi


PËRFITUESI

Shoqëria "Solaris Capital Trust" shpk

Administratori

Aniso Seferi





